



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, ADMINISTRIMIT FINANCËS DHE MARRËDHËNIEVE
ME JASHTË

PROTOKOLL - ARKIVA
KARTELË SHOQËRUESE E PRAKTIKËS

Dërgues Albgar

Nr.Prot. 43, data 21.03.2018

Shkurtimi i lëndës Dërgim i Planit Objektiv për të zhvillimit (2018-2028)

Për trajtim nga: (struktura të tjera të ngarkuara)	<u>J. Juridike, J. Licensimit, J. Scrum</u>
Me porosi:	<u>Me detyrim të fortë</u>
Për dijani:	<u>Banoh</u>

Afati: Normal (7 ditë) Prioritet (3 ditë) Urgjent (brenda ditës) Pa afat/për dijani
Tjetër ___ ditë

Data 23.3.18 Nr.Prot 277,

Nënshkrimi: (Kryetari)

Marrë në dorëzim 27.3.2018

Nënshkrimi:

Kalon për trajtim (Drejtoria): _____
Me porosinë: _____

Marrë në dorëzim _____ Nënshkrimi: _____

Kalon për trajtim (Sektori): _____
Me porosinë: _____

Marrë në dorëzim _____ Nënshkrimi: _____

Kalon për trajtim Specialisti: _____
Me porosinë: _____

- Trajtimi i materialit përfunduar më: _____ Specialisti
- Trajtimi i materialit pranuar më: _____ Eprori në shkallë hierarkike
- Trajtimi i materialit miratuar më: _____ Eprori në shkallë hierarkike
- Trajtimi i materialit miratuar më: _____ Eprori në shkallë hierarkike

Drejtuar: Z. Petrit AHMETI
Kryetar
Enti Rregullator i Energjisë

TIRANË

Lënda: Dërgim i Planit Dhjetëvjeçar të Zhvillimit (2018-2028)

I nderuar Z. Ahmeti,

Në mbështetje të zhvillimit të strategjise afatgjatë për Sektorin e Gazit Natyror nga ku është krijuar Shoqëria Albgaz Sh.a , me V.K.M. nr. 848, datë 07.12.2016, “Për krijimin e Shoqërisë “Albgaz” Sh.a. dhe përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive “Albpetrol” Sh.a. dhe “Albgaz” Sh.a.”, si dhe në përmbushje të parashikimeve të ligjit Nr.102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror, Ju bëjmë me dije se;

1. Duke marrë në konsideratë angazhimet tona si shoqëri tregtare si dhe për të realizuar sa më efektivisht mirëmbajtjen dhe operimin e rrjetit të Transmetimit dhe Shpërndarjes së Gazit Natyror, Shoqëria Albgaz Sh.a. paraqet Planin e Investimeve, në përputhje me kërkesat e nenit 16, pika 12; nenit 46, nenit 56 të Ligjit nr.102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”.

- Bashkëlidhur gjeni Planin Dhjetëvjeçar të Zhvillimit (2018-2028)



Duke Ju falenderuar paraprakisht për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin.

Me respekt,

Genci GJEÇI
ADMINISTRATOR

OPERATORI I KOMBINUAR I GAZIT NATYROR

ALBGASZ Sh.a.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË



**KËSHILLI MBIKQYRËS
OPERATORI I KOMBINUAR I GAZIT NATYROR (ALBGASZ Sh.A)
TIRANË**

VENDIM

NR. 02 datë 09.02.2018

MBI

- PLANIN DHJETËVJEÇAR I ZHVILLIMIT

Këshilli Mbikqyrës i Shoqërisë "Albgaz" Sh.A , i përbërë nga:

- **Z. Nikolla LERA** Anëtar
- **Z. Enton DURO** Anëtar
- **Z. Knidi BASHARI** Anëtar
- **Z. Salarjon TOTAJ** Anëtar
- **Z. Stavri DHIMA** Anëtar
- **Z. Tommy KOLA** Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 09/02/2018, ora 11/00, të zhvilluar në ambjete të selisë së Albgaz Sh.a;

Shoqëria Albgaz Sh. a realizon objektin e veprimtarisë së saj sipas Ligjit nr. 102/2015, "Për Sektorin e Gazit Natyror".

Me Vendimin Nr. 848, datë 07.12.2016, për "Krijimin e Shoqërisë "Albgaz" Sh.A. dhe për Caktimin e Autoritetit Publik që Përfaqëson Shtetin si Pronar të Aksioneve të Shoqërive Albpetrol Sh.A. dhe Albgaz Sh.A.", Këshilli i Ministrave, ka krijuar autoritetin publik që është përgjegjës për trasmetimin, shpërndarjen dhe depozitimin e gazit natyror në Republikën e Shqipërisë, e cila është Shoqëria "Albgaz" Sh.A.

Në vijim të kësaj VKM-je, në datë 05.01.2017, aksioneri i vetëm i Shoqërisë "Albgaz" Sh.A., Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, ka aprovuar statutin e kësaj Shoqërie dhe ka kryer regjistrimet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit sipas



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

kërkesave të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar.

Në zbatim të Udhëzimit Nr.394 Datë 21.08.2014 “Mbi Programet e Zhvillimit Ekonomik të Shoqërive Tregëtare me Kapital Shtetëror”, si dhe ligjit Nr.102/2015, date 23.09.2015 “Per Sektorin e Gazit Natyror”, Neni 46, shoqëria Albgaz Sh.A. ka hartuar Planin Dhjetëvjeçar të Zhvillimit të Rrjetit të Transmetimi, Programin e Zhvillimit Ekonomik për vitin 2018, si dhe për 3 (tre) vjeçarin e ardhshëm 2018-2021 në përputhje me objektivat e përcaktuara nga organet drejtuese.

Keshilli Mbikqyres i shoqërisë Albgaz sh.a pasi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Administratori i shoqërisë, në mbledhjen e datës 09/02/2018:

VENDOSI :

- **1. PLANI DHJETËVJEÇAR I ZHVILLIMIT**

1. Ky vendim i përcillet për dijeni Ministrisë së Infrastruktures dhe Energjisë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas miratimit të Asamblese së Përgjithshme.

KËSHILLI MBIKQYRËS

Nikolla LERA

ANËTAR

Stavri DHIMA
ANËTAR

Enton DURO
ANËTAR

Tommy KOLA
ANËTAR

Salarjon TOTAJ
ANËTAR

Knidi BASHARI
ANËTAR

Sekretare e Këshillit Mbikqyrës:

Edlira ZYFI

Plani Dhjetëvjeçar i Zhvillimit 2018-2028

Kapitujt:

1. Përmbledhje ekzekutive

2. Përmbledhje e kompanisë

2.1 Themelimi, Identiteti, Persona kyc

2.2 Objektivat

2.3 Plani i Zhvillimit Ekonomik.

3. Misioni, vlerat, vizioni

4. Aktiviteti tregtar

4.1 Përshkrimi i aktivitetit

4.2 Mjedisi industrial, rregullator/politik, ekonomik dhe social

4.3 Teknologjia dhe Infrastruktura

5. Analiza e tregut

5.1 Segmentimi i tregut

5.2 Strategjia e segmentimit të tregut

5.3 Analiza e aktorëve në industri

5.3.1 Pesë forcat në një industri: fuqia e blerësve, fuqia e furnitorëve, hyrësit e rinj, rivaliteti me konkurrentët, zëvendësuesit.

6. Strategjia dhe implementimi

6.1 Analiza SWOT, avantazhi konkurrues.

6.2 Strategjia Marketing: 4 P.

6.3 Aleancat strategjike

7. Përmbledhje e Manaxhimit

7.1 Struktura organizative dhe niveli manaxherial

8. Plani financiar

8.1 Fitimet dhe humbjet e projektuara (Plani i Zhvillimit Ekonomik dhe Buxhetimi)

9. Kontrolli dhe Auditimi

1. Përmbledhje Ekzekutive

Kompania Albgaz sh.a është operatori i kombinuar në sektorin e gazit natyror përgjegjës për linjat aktuale dhe të pritshme për transmetimin. Tregu i energjetikës manifeston një kërkesë në rritje për konsum energjie, qoftë nga industria, biznesi apo rezidentët. Një pjesë e kërkesës për energji nuk mbulohet nga prodhimi vendas, duke importuar një përqindje të konsiderueshme në rritje të energjisë elektrike nga vëndet fqinjë. Prodhimi hidrokarbureve (naftë, gaz) gjithashtu mbulon një pjesë modeste për sektorin e transportit. Kompania synon të mbulojë kërkesën vëndase për energji duke mundësuar furnizimin e konsumatorëve me gaz natyror, nëpërmjet infrastrukturës së transmetimit dhe shpërndarjes.

Gas Masterplani, investimet e pritshme të TAP AG, do të luajnë rol kritik në rivitalizimin e sektorit të gazit natyror, duke ofruar një shans strategjik për shoqërinë tonë. Albgaz do të kryejë aktivitetin e vet tregtar në përputhshmëri me Ligjin për Sektorin e Gazit 102/2015, Direktivave Europiane 2009/73 EC, duke njëtrajtësuar politikën, procedurat dhe praktikën e konsoliduara europiane në këtë sektor.

Në koordinim me Entin Rregullator, kompania ushtron aktivitetin e saj me efektivitet, eficiency, transparencë, dhe ofron kushte aksesit të barabarta (në varësi të kapacitetit teknik) palëve të treta të interesuara.

Kompania Albgaz sh.a është në fazën e certifikimit dhe licensimit për aktivitetet e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror dhe në të ardhmen mund të zgjerojë veprimtarinë tregtare duke u përfshirë në sektorin e depozitimit të gazit, duke qënë se po ndërmerren studime fizibiliteti për depozitat natyrore nëntokësore në Divjakë e Dumre.

2.1 Shoqëria Albgaz sh.a., e regjistruar në QKB, është një shoqëri aksionere me ofertë private, ku 100% të aksioneve zotërohen nga Republika e Shqipërisë, nëpërmjet Ministrisë së Zhvillimit



Ekonomik, Tregtisë, Sipërmarrjes dhe Turizmit (shkrirë dhe rithemeluar si Ministria e Financave dhe Ekonomisë).

Sipas statutit të shoqërisë Albgaz, objekti i veprimtarisë së shoqërisë konsiston në ofrimin e gazit natyror nëpërmjet rrjetit të transmetimit, shpërndarjes, depozitimit dhe të impiantit të gazit natyror. Shoqëria realizon objektin e veprimtarisë së saj sipas Ligjit nr. 102/2015, "Për Sektorin e Gazit Natyror".

Vendimmarrja dhe administrimi i Shoqërisë është strukturuar sipas sistemit me dy nivele, në përputhje me Kapitullin III të Ligjit për Shoqëritë Tregtare. Organet drejtuese të Shoqërisë janë:

- a. Asambleja e Përgjithshme;
- b. Këshilli Mbikëqyrës;
- c. Administratori.

2.2 Objektivat

Shoqëria Albgaz sh.a operon në sektorin e gazit natyror si operator i kombinuar, duke u angazhuar në transmetimin, shpërndarjen e gazit natyror.

Objektivat e shoqërisë janë:

-Furnizimi i klientëve nëpërmjet rrjetit të transmetim/shpërndarjes sipas kërkesave të volumit, cilësisë dhe specifikave për të garantuar sigurinë e furnizimit, dhe ofrimin e një alternative energjetike kundrejt hidrokarbureve apo hidrocentraleve.

-Përmirësimi, rinovimi dhe zgjerimi i infrastruktures së rrjetit të transmetim/shpërndarjes në kuadër të politikave kombëtare referuar Ligjit 102/2015, "Për Sektorin e Gazit Natyror" dhe bashkëpunimi i ngushtë me shoqëritë analoge europiane për lidhjen e rrjeteve interkoneksion, për të diversifikuar dhe garantuar furnizimin me energji.



-Ofrimi i shërbimit të transmetimit, shpërndarjes, depozitimit dhe impianteve të gazit ndërmerret ne bazë të parimeve të: efciences në kosto, cmimeve konkurruese, transparente dhe jo-diskriminuese dhe impaktit të ulët mjedisor.

3.Misioni, vlerat, vizioni.

3.1 Misioni dhe vlerat

Misioni i shoqërisë Albgaz sh.a. është të transmetojë dhe shpërndajë gaz natyror te konsumatori, sipas sasisë dhe specifikave të kontraktuara, me efciencë, efektivitet afatgjate dhe profesionalizëm. Misioni mbështetet te Ligji 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” ku synohet furnizimi me gaz natyror pa ndërprerje, me cmime jo-diskriminuese dhe ku cdo palë e tretë e interesuar ka të drejtën për akses. Vlerat e shoqërisë konsistojnë në efciencie dhe profesionalizëm në shërbimin e ofruar, integritet, frymë bashkëpunimi dhe motivim për t`u rritur individualisht dhe në nivel organizate.

3.2 Vizioni

Vizioni i Albgaz sh.a është të ofrojë një alternativë konkurruese në sektorin energjetik, duke u rritur në një aktor industrial të rëndësishëm dhe që synon të mbështesi me ane të aktivitetit sektorët e industrisë, biznesit dhe rezidentët.

4.Aktiviteti tregtar dhe mjedisi i jashtëm

4.1 Përshkrimi i aktivitetit të shoqërisë

Aktiviteti i operatorit të kombinuar Albgaz sh.a ushtrohet me anë të licensës së lëshuar nga Enti Rregullator i Energjisë. Në përputhje me licensen shoqëria ka të drejten të ndërtojë, zotërojë, operojë, mirëmbajë dhe zhvillojë një system të sigurt nga rreziqet dhe eficient të transmetimit të



gazit natyror në një treg të udhëhequr nga konkurrenca si edhe kapacitete të mjaftueshme për të plotësuar kërkesën e arsyeshme të gazit natyror në një territor të caktuar dhe që me anë të kapitalit fizik, financiar dhe intelektual të përmbushi detyrimet e shërbimit.

4.2 Mjedisi Industrial, Rregullator/politik, socio-ekonomik.

a. Industria e energjetikës evidenton disa mangësi në furnizimin eficient dhe të sigurt të konsumatorëve të llojeve të ndryshëm. Vëndi gjeneron energjinë kryesisht nëpërmjet hidrocentraleve dhe hidrokarbureve. Hidrocentralet gjenerojnë energji elektrike nga e cila furnizohen industritë e tjera të prodhimit/përpunimit, sektorët e biznesit, institucionet dhe pjesa dërmuese e popullsisë rezidente. Burimi energjie kritik përbëjnë edhe hidrokarburet (nafta, benzina) të cilat përdoren gjërësisht në transport dhe më pak për furnizimin e uzinave të prodhimit/përpunimit. Përsa i përket sektorit të gazit natyror, shoqëria gëzon një pozitë monopoli natyror, pasi është i vetmi operator në sistemet e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror. Shoqëritë e gjenerimit të hidrokarbureve dhe gazit natyror janë të shumtë, kurse në sistemet e transmetimit/shpërndarjes kemi 2 dhe një operatorë, respektivisht në sektorin elektroenergjetik dhe atë të gazit. Sfidat e furnizimit me energji përfshijnë plotësimin e kërkesës të brëndshme për hidrokarbure me anë të prodhimit vëndas. Por sipas periudhës 2001-2014, vetë-përmbushja e kërkesës vëndase për burime energjie ka pësuar rënie deri në 40%, cka nënkupton një raport në rritje të importit të burimeve të energjisë. Së fundmi, po merr hov zhvillimi i impianteve foto-voltaike, si alternative konkurruese energjetike, duke u mbështetur nga shteti shqiptar si një investim atraktiv kundrejt burimeve tradicionalë jo të rinovueshëm.

b. Mjedisi rregullator/politik dikton aktivitetin e industrisë dhe shoqërisë tregtare Albgaz sh.a. Kjo për shkak se tregu është në tranzicion të hershëm liberalizimi krahasuar me vëndet e Europës dhe kësisoj manifestohet një rregullim strikt i ushtruar nëpërmjet qeverisë, Entit Rregullator. Shteti është pronar i 100% të aksioneve dhe ushtron të drejtën e vendimmarrjes dhe mbikqyrjes nëpërmjet Asamblesë së Përgjithshme dhe Këshillit Mbikqyrës.

- c. Mjedisi socio-ekonomik i vëndit cilësohet e një shkallë ekonomike në tranzicion, nga një ekonomi e centralizuar drejt një ekonomie tregu liberale. Prodhimi i brëndshëm bruto për *capita* është rritur në dy dekadat e fundit si rezultat i një sërë faktorësh, përfshirë planet e zhvillimit ekonomik të mbështetura financiarisht nga institucione financiare europiane dhe botërore si Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Europiane për Zhvillim dhe Rindërtim, etj. Sfidat e sigurimit dhe përdorimit eficient të burimeve të energjisë kanë përbërë çështje kyce në rendin gjeo-politik të Republikës dhe me anë të koopërimit strategjik me partnerët ndërkombëtarë, një mori planesh për investime dhe rinovime janë ndërmarrë; duke konsideruar infrastrukturën aktuale, shpërndarjen e popullsisë, urbanizimin, të ardhurat për frymë, profilizimin e konsumatorëve sipas nivelit industrial, komercial dhe rezidencial.

Sfidat aktuale që sektori i energjisë në Shqipëri has përfshijnë:

- Arritja e një standardi ekonomik në sektorë të ndryshëm dhe rritja e nivelit të konsumit të energjisë për *capita*;
- Përmirësimi i trendit të intensitetit të energjisë;
- Rritje e sigurimit të energjisë nëpërmjet përmirësimit të eficiencës, rritjes së rolit të burimeve të rinovueshme (krahas hidrocentraleve, sisteme eolike, sisteme foto-voltaike, të dallgëve/rrymave, etj), dhe reduktimi i varësisë nga importi.

Historikisht, konsumi i energjisë në Shqipëri për banorë është i ulët, cka tregon aktivitete ekonomike me shpenzim energjie të ulët, e përqendruar kryesisht në sektorin e biznesit. Gjithashtu niveli i komfortit të rezidentëve duket të jetë i ulët. Nga ana tjetër, intensiteti i energjisë, i përlogaritur si raporti i energjisë së ofruar me PBB në një vit, është mjaft i lartë, krahasuar me vëndet e Ballkanit. Industria e rëndë në Shqipëri kontribon në shpenzimin intensive të energjisë, si është rasti i minierave dhe metalurgjisë. Por sfida kyce është rritja e konsumit të energjisë për kokë, ndërkohë që reduktohet intensiteti i lartë i konsumit të energjisë në industrinë e rëndë të vëndit.

4.3 Teknologjia dhe Infrastruktura

Infrastruktura e sistemit të gazsjellësit në vënd është pjesërisht e amortizuar dhe daton e prodhimit të viteve 70', teknologjia e së cilës origjinon nga Zvicra. Një rinovim tërësor i



infrastrukturës së gazsjellësit pritet të realizohet në kuadër të investimeve strategjike me rëndësi kombëtare (Gas Masterplani), ku gazsjellësi TAP AG do të ketë rol suportues në konceptimin, planifikimin dhe implementimin e projektit.

5. Analiza e tregut

5.1 Segmentimi i tregut

Shoqëria Albgaz sh.a do të synojë të furnizojë me gaz natyror nëpërmjet transmetimit/shpërndarjes *fabrikat e industrisë së rëndë* të angazhuara në metalurgji, cimento dhe produkte të tjera gurorë. *Konsumi rezidencial* është pothuajse i papërfillshëm, por me rinovimin e infrastrukturës dhe në varësi të implementimit të projektit prioritar në Vlorë, pritet një zgjerim i tregut të furnizimit me gaz natyror, duke i dhënë mundësi për akses bizneseve dhe rezidentëve. Duhet të ritheksojmë se Albgaz është i vetmi operator i kombinuar (transmetim e shpërndarje) aktiv në sektorin e gazit natyror, prandaj pozicioni i nje monopoli natyral evidentohet kështu. Zinxhiri i vlerës në sektorin e gazit natyror fillon tejshkon këto hallka:

- prodhimi dhe/ose përpunimi,
- transmetimi dhe shpërndarja,
- depozitimi dhe impianti i gazifikimit si hallkë paralele e të mësipërme,
- furnizimi dhe tregtimi.

Në hallkën e dytë shoqëria është operator i vetëm në treg. Aktiviteti i transmetimit ka si qëllim transportin e gazit drejt stacioneve të komprimimit, për t'u shpërndarë më tej në zonat e banuara, për bizneset dhe konsumatorët fundorë.

5.2 Strategjia e segmentimit të tregut

Strategjia e segmentimit të tregut është relativisht e drejtpërdrejt në rastin tonë. Gas Masterplani për sektorin e gazit natyror në Shqipëri do jetë përgjegjës për zhvillimin e strategjisë së energjetikës, duke ofruar një alternativë reale të furnizimit me energji kundrejt burimeve



tradicionalë, të tejkaluar nga kërkesa vëndase, dhe që varen gjithnjë e në rritje nga importi i energjisë nga jashte, gje e cila sjell kosto të larta në afatgjatë.

Projekti me prioritet **PIPI** Vlorë, synon të plotësojë kërkesën për energji, në mënyrë konstante, eficiente dhe të sigurt të zonës përreth ku përfshihen zona industrial Fier-Vlorë, bizneset e këtyre qyteteve dhe pjesa e popullsisë e cila do të ndërrojë/shtojë platformën e furnizimit me energji.

PIPI pritet të përfundohet gjatë 3 viteve të ardhshme, kohë që përkon me përfundimin dhe komisionimin e gazsjellësit TAP, prej të cilit furnizohet infrastruktura e PIP1. Projekti do të përdorë gazin natyror nga gazsjellësi TAP për të furnizuar TEC e Vlorës, e cila do të gjenerojë elektricitet për rajonin e synuar.

Theksojmë se është gjithashtu përgjegjësi e shtetit shqiptar, përfaqësuar nëpërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Energjetikës dhe Industrisë dhe partnerëve investues në këtë Gas Masterplan, për të promovuar alternativën e gazit natyror dhe të ofrojë politika incentivuese për aplikimin e kësaj alternative. Fillimisht do të lidhen në rrjetet e transmetimit/shpërndarjes fabrikat e prodhimit industrial. Më tej do synohet aplikimi i gazit natyror si burim ngrohje dhe funksionesh të tjera shtëpiakë ose institucionalë, sic mund të jenë shkollat, kopshtet, institucionet e administratës publike, etj.

Shoqëria me mbështetjen e Ministrive të lart-referuara, do të tërheqi këto grupe-konsumatorësh fillimisht për të gjeneruar interesin dhe për të provuar efektivitetin, zgjidhjen e ceshtjes së furnizimit kundrejt një efience në kosto, e cila reflektohet në cmimin konkurrues dhe më të favorshëm kundrejt energjisë elektrike të gjeneruar nga hidrocentralet.

Me instalimin e impianteve që konvertojnë gazin natyror në energji termale apo elektrike, konsumatori do të përfitojë incentiva (për shpenzimin fillestar të impiantit), të cilat të shtrira në kohë sjellin ekonomizim të shpenzimit për energji, duke u mbështetur edhe nga kosto variable e harxhimit për njësi energjie.

5.3 Analiza e aktorëve në industri (5 Forcat e industrisë)

Shoqëria Albgaz operon në hallkat e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit, nga prodhuesi te furnitori, në rastin aktual te konsumatori direkt. Në sektorin e gazit natyror kemi më pak aktorë në mjedis, duke u kufizuar në 2-3 prodhues, një transmetues dhe shpërndarës, dhe disa kompani private të angazhuara në furnizimin me gaz. Po të shqyrtojmë tërësinë e industrisë, evidentohen 5 forca influencuese ndaj shoqërisë Albgaz.

- 1. Fuqia e furnitorit.* Rolin e furnitorit e luan gjeneruesi i energjisë, Albpetroli për hidrokarbure dhe gaz natyror. Furnitori ka marrëdhënie kontraktuale me kompaninë tonë, për arsye se jemi i vetmi operator në rrjetin e transmetim/shpërndarjes. Furnitori negocion me klientin (ne exit-point të transmetimit) dhe dakordësohet me shoqërine tonë rreth sasive dhe cilësisë së gazit të kontraktuar. Albgaz ka detyrimin sipas kapacitetit në dispozicion, të zbatojë kërkesën për furnizim, e cila është rënë dakort midis gjeneruesit dhe blerësit të gazit (klientit).
- 2. Fuqia e blerësit.* Blerësi është konsumatori i gazit natyror, qoftë i sektorëve industrialë, tregtarë apo rezidentëve. Blerësi këtu ka fuqi negociuese për shkak se mund të zgjedhi alternativat e tjera energjetike si elektriciteti nga hidrocentralet. Më pak fuqi negociuese evidentohet te disa blerës të sektorit industrial, të cilët kanë ngritur infrastrukturën të kushtueshme për furnizim me gaz natyror dhe konsumojnë energji me intensitet të lartë, e cila nuk i premtion përfitueshmëri në rast të furnizimit me elektricitet. Blerësi negocion kontratën me prodhuesin e gazit natyror, dhe zgjedhin sasinë e lëvrimit, specifikat e presionit dhe cilësisë dhe dakordësohen për një cmim take-or-pay sipas një metodologjie tarifore të mirëpërcaktuar nga Enti Rregullator Energjetik.
- 3. Konkurruesit.* Brënda sektorit të gazit natyror, në hallkën e transmetimit dhe shpërndarjes jemi monopol natyral.



4. *Zëvendësuesit.* Zëvendësuesit janë konkurrenti jonë indirekt, pasi përfaqësojnë alternativën më të ngjashme të furnizimit me energji nëpërmjet rrjeteve të transmetimit. Burimet e rinovueshme që gjenerojnë elektricitet zejnë pjesën më të madhe të tregut të konsumit të energjisë, përfaqësuar tërësisht nga sistemet foto-voltaike, dhe kompania jonë zë një pjesë të papërfillshme në këtë sens.

5. *Hyrësit potencialë.* Mundësi reale hyrësish të rinj në hallkën e transmetimit dhe shpërndarjes janë të zbehta. Por, nuk përjashtohen aktorë të rinj në treg, të cilët mund të angazhohen në gjenerimin ose furnizimin me gaz natyror. Një prospekt tjetër potencial është operimi i impianteve të gëzimit të lëngëzuar dhe transporti i tyre me anë të anijeve specifike LNG. Por ky aktivitet kërkon kohë dhe investime madhore për t'u konkretizuar dhe është një çështje që i tejkalon kufijtë kohorë që janë objekt i këtij plani biznesi.

6. Strategjia dhe implementimi

Shoqëria Albgaz është në vitin e parë të aktivitetit të saj tregtar. Momentalisht shoqëria është në fazën e rikuperimit të aseteve, dhe operon me humbje. Investime themelore nevojiten në rinovimin dhe zgjerimin e infrastrukturës së rrjetit të transmetimit, shpërndarjes. Gas Masterplani është kritik për konkurrimin afatgjatë dhe të sukseshëm të shoqërisë në sektorin energjetik të gazit natyror. Për implementimin e Masterplanit një buxhet i posaçëm do t'i alokohet shoqërisë dhe gjatë progresit të projektit investime të vazhdueshme priten të realizohen. Investimet duhen të konsiderojnë shpenzimet fillestare dhe kthimin e tyre të pritur nëpërmjet FCRT, IRR, ROI apo NPV. Më tej duhet të përlllogaritet përfitueshmëria dhe likuiditeti me anë të treguesve të mëposhtëm:

- tarifa mesatare e transmetimit e cila rezulton në një IRR (normë e kthimit të brendshëm prej 8%),
- nivelimi i kostos së transmetimit,
- EBITDA, fitimit para interesit, taksave, amortizimit,



-stabiliteti financiar.

FCRT (Full Cost Recovery Tariff) do të jetë instrumenti i pikënisjes së metodologjisë së tarifës, e cila do të përcaktojë fitimin e lejuar të shoqërisë gjatë vitit kontabël.

Në bashkëpunim të ngushtë me ERE, Albgaz do të ketë një metodologji tarifore adekuate të përshtatur për tregun ku bën pjesë si dhe duke konsideruar kostot e investimit fillestar dhe shpenzimet operative.

Shoqëria ka marrë certifikimin paraprak nga ERE dhe pritet të finalizojë procedurat e licensimit për aktivitetin e trasnmetimit dhe shpërndarjes.

Paralel me ndjekjen e procedurave ligjore shoqëria është angazhuar në bisedime kontraktuale me prodhues dhe furnitorë të sektorit të gazit.

Përpos qëllimit për sigurimin e të ardhurave nga lidhja e kontratave me aktorët e tjerë në treg, kompania zotëron edhe një departament të marrëdhënieve publike, përfshirë marketingun. Kompania Albgaz synon të informojë klientët potencialë rreth ekzistencës, kapacitetit dhe strategjisë së saj, për të gjeneruar interes dhe për të rezervuar kapacitete në të ardhmen.

6.1 Analiza SWOT, avantazhi konkurrues

• **Fuqitë:**

- Staf i me përvojë dhe i përkushtuar në këtë sektor;
- Trajnime të mëtejshme në O&M, Menaxhim e Logjistikë;
- Investimet e reja priten të fuqizojnë pozicionin konkurrues;

• **Dobësitë:**

- Infrastruktura aktuale kufizon aktivitetin dhe ul përfitueshmërinë;
- Mungesë informacioni dhe e një databaze industrie që rezulton nga pamjaftueshmëria e studimeve të certifikuara në këtë industri.



- **Shanset:**

- Risia e ofertës në treg kundrejt zëvendësuesve;
- Potencial zhvillimi duke u lidhur me TAP dhe më vonë IAP;
- Potenciali i integritit të sistemeve të transmetimit me impiantet e lëngëzimit të gazit natyror;

- **Rreziqet:**

- Risku i projektimit teknik;
- Risku financiar i projektit dhe/ose braktisja e Gas Masterplanit;
- Rreziku konkurrues nga burimet e rinovueshme;
- Rreziku i hyrësve të rinj në treg dhe konkurrenca e ashpër.

Avantazhi konkurrues do të formohet duke u mbështetur te fuqitë e shoqërisë, t'i zhvillojë ato më tej për t'u diferencuar nga konkurrentët apo hyrësit e rinj në treg. Dobësitë meritojnë vëmendje pasi ato duhen zbutur dhe për të garantuar një qëndrueshmëri kundrejt mjedisit dinamik e konkurrues. Gjithashtu organizata duhet të eksplorojë dhe shfrytëzojë shanset që i paraqiten dhe të marri masa zbutëse ose evituese për menaxhimin e risqeve që vijnë nga mjedisi i jashtëm. Një plan kontigjence duhet përpiluar në vijim të kësaj pike.

6.2 Strategjia Marketing

- **Marketingu i produktit/shërbimit.** Marketingu i shërbimit, të cilin Albgaz ofron, përbën thelbin e marketingut së bashku me strategjitë e cmimeve. Gazi natyror duhet t'i bëhet e njohur publikut dhe vecanërisht klientelës së targetuar, si një komoditet bazik, i cili mundëson funksionimin e aktiviteteve të përditshme të një individi, grupi pune, sipërmarrjeje të vogël, të mesme apo të madhe dhe së fundi fabrikave të industrisë së lehtë dhe të rëndë. Sektori i transportit përbën një konsideratë strategjike për të ardhmen,



duke integruar GNL ose gazin e kompresuar. Por çështja e cilësisë dhe specifikave të gazit natyror është objekt kompetence i firmave prodhuese dhe përpunuese të hidrokarbureve dhe gazit natyror. Albgaz duhet të garantojë saktësinë, eficiencën dhe shpejtësinë e transmetimit të gazit nga prodhuesi (off-take) te konsumatori (on-take) duke ruajtur specifikat e kontraktuara midis prodhuesit dhe blerësit. Sic dhe u përshkrua më sipër, Gas Masterplani ka synim pikërisht planifikimin, ndërtimin, rinovimin dhe komisionimin e një infrastrukture modern dhe sistemeve përkatëse të komprimimit, matjes dhe lëngëzim/gazifikimit.

- *Strukturat tarifore.* Enti Rregullator Energjetik harton dhe aprovon metodologjinë e tarifave të aktiviteteve në sektorin e gazit natyror, në përputhje me Ligjin për Gazin Natyror 102/2015.
- *Marketingu promocial dhe komunikimi me publikun.* Marketingu promocial do të konsistojë në promovimin e shërbimit të transmetimit dhe shpërndarjes duke ofruar kontrata tërheqëse subjekteve të industrisë, për t'i stimuluar të ndërrojnë mënyrën e furnizimit me energji. Një plan i gjërë paraprak i stimulimit të kërkesës duhet ndërmarrë me qëllim që investimet infrastrukturore të kenë një normë kthimi të pranueshme. Studimi i nevojave të tregut dhe parashikimi i investimeve urbane në rajonin e synuar (Fier-Vlorë; Tiranë-Durrës) përbën parakusht për procedimin e praktikave të promovimit dhe nxitjes publike për gazin natyror. Komunikimi me publikun pasqyron vizionin, identitetin dhe qëllimet e kompanisë në këtë sektor dhe mirëmban, zhvillon apo krijon marrëdhënie afatgjata dhe konstruktive me aktorët e interesuar apo të prekur nga veprimtaria e shoqërisë sonë.

6.3 Aleancat strategjike



Kompania Albgaz sh.a. ka nënshkruar disa memorandume mirëkuptimi me kompanitë homologe të Italisë (Snam s.r.l), Spanjës (Enagas) dhe Greqisë (Desfa), Holandës (Gasunie) si dhe është pjesë e një bashkëpunimi të ngushtë me kompaninë TAP AG, e cila në kuadër të projektit TAP, është zotuar të përkrahi dhe financojë ringritjen e infrastrukturës së transmetimit të gazit natyror në vendndodhjet ekzistuese në Shqipëri.

Në kuadër të marrëveshjes me TAP AG për operimin dhe mirëmbajtjen e gazsjellësit TAP, kompania Albgaz sh.a është angazhuar në një aktivitet tregtar të shtuar që zgjeron kapacitetin dhe aftësitë e firmës në këtë sektor. Programi i mirëmbajtjes dhe operimit të gazsjellësit në territorin e Shqipërisë nënkupton trajnimin dhe kualifikimin e një stafi të përzgjedhur dhe nëpërmjet një bashkëpunimi Joint-Venture, të kryejë aktivitetet e kontraktuara nga TAP AG. Marrëveshja për O&M mbështetet nga marrëveshja e nënshkruar midis TAP AG dhe Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave.

7. Përmbledhje e Manaxhimit

7.1 Struktura organizative dhe niveli manaxherial

Shoqëria Albgaz sh.a. është një shoqëri aksionare me kapital 100% shtetëror, me dy nivele, Asambleja e Përgjithshme dhe Këshilli Mbikqyrës. Asambleja e Përgjithshme është organi vendimmarrës më i lartë në shoqëri dhe Këshilli Mbikqyrës ushtron detyrimin dhe të drejtën e monitorimit të aktivitetit të Albgaz-it. Struktura organizative përngjason me atë të një kompanie tregtare, me nivele hierarkike tradicionale por mund të ndryshohet në varësi të ndërmarrjes së përbashkët strategjike, Joint-Venture, e cila mund të jetë e formës së inkorporuar (Incorporated JV) ku një pjesë e organizatës ose e tërë organizata bashkëformon një entitet të ri juridik me partnerin strategjik të zgjedhur ose mund të jetë nëpërmjet marrëveshjes për Joint-Venture (e kontraktuar), ku secila palë ndan detyrimet, përgjegjësitë dhe të drejtat për një projekt strategjik ose treg të caktuar.



Administratori ka funksionet dhe kompetencat e një shefi ekzekutiv, i cili mbështetet nga Sekretariati dhe Këshilltarët. *Drejtoria Tregtare* mbulon detyrat e planeve operacionale, tregtarë dhe strategjike dhe ndjek zhvillimet e tregut të energjisë (përfshirë sektorin e gazit natyror) kombëtar, rajonal dhe europian.

Drejtoria Teknike fokusohet në bilancet në rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes dhe kontribon në përmirësimin e performancës teknike të transmetimit duke ofruar zgjidhje për rritjen e efikasitetit, përmirësimin e monitorimit dhe reduktimin e avarive dhe humbjeve.

Drejtoria e Projekteve dhe Marrëveshjeve mbulon një sërë detyrash dhe përgjegjësish, kryesisht në zhvillimin dhe oportunitetet e organizatës dhe në rritjen e saj. Krijimi i vlerave afatgjata të kompanisë, marrëdhëniet me konsumatorët kyc, partnerët dhe grupe të tjera interesi përbëjnë disa nga kompetencat e kësaj drejtorie. Së fundi, me rëndësi vitale për organizatën është programimi, implementimi dhe monitorimi i projekteve.

Drejtoria e Financës, Kontabilitetit dhe Programimit. Detyra dhe kompetencat konsistojnë në:

- politikat e kontabilitetit dhe procedurat,
- llogari -mbajtjen dhe raportimin e sistemeve,
- planifikimin dhe parashikimin,
- praktikat dhe procedurat buxhetore dhe financiare si dhe:
- Përgjegjësitë mbikëqyrëse.

Qëllimi i menaxhimit të mirë financiar është për të siguruar që shoqëria të operojë si një ndërmarrje financiarisht të qëndrueshme.

Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse. Detyrat dhe Përgjegjësitë Kryesore:

- Menaxhon shërbimet që janë në mbështetje të realizimit të aktiviteteve të Shoqërisë,
- Mbështet strukturat e shoqërisë me opinione ligjore, ndjek dhe realizon përfaqësimin në gjyq të proceseve gjyqësore në të cilat përfshihet shoqëria,
- Mbështet strukturat e tjera me shërbimet mbështetëse (automjete, shërbimet e mirëmbajtjes, IT, shërbime operacionale etj.),
- Menaxhon dhe planifikon Burimet Njerëzore të Shoqërisë,
- Menaxhon Proceset e Prokurimit sipas legjislacionit në fuqi,
- Autorizon lëvizjen e bazës materiale duke kontrolluar efikasitetin e përdorimit të saj nga strukturat përkatëse.

8. Programi I Zhvillimit Ekonomik I VITIT 2018

Plani i Investimeve

Plani i investimeve në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të Albgaz sh.a. dhe krijimit të një strukture funksionale për operimin e transmetimit të gazit sipas kërkesave, mbulimi financiar i tyre

A. Për ngritjen e kapaciteteve teknike: (45 000 € / 6 075 000 ALL)

- Trajnimi i stafit të DPM në drejtim të projektimit, inspektimit, masave HSE në përputhje me nevojat që shfaqin linjat ekzistuese dhe ato që parashikohen të riparohen apo të ndërtohen nga fillimi.
- Te garantohet literatura didaktike (në variant hardcopy ose digjital) për rritjen e mëtejshme të kapaciteteve të kësaj drejtorie

B. Për krijimin e kushteve bashkohore: (55 000 € / 7 425 000 ALL)

- Programe (software) inxhinierik dhe programe për regjistrim e rekordeve të ndryshme apo ndjekjen e ecurisë së projekteve.
- Ploter inxhinierik për formatet A2, A1, A0

C. Për pajimin e personelit për aktivitetin në terren: (110 000 € / 14 850 000 ALL)

Furnizimi me pajisje të nevojshme për kryerjen e detyrave të kësaj drejtorie si:

- Pajisje rievuese
- Pajisje matëse
- Pajisje inspektuese dhe testuese
- Pajisje për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë (HSE): sinjalizues, pajisje detektuese manuale dhe automatike për rrjedhjen e gazit dhe prezencën e gazrave helmues, etj
- Pajimi PPE, etj.



D. Në rast se ndërhyrjet mirëmbajtëse dhe rehabilituese në rrjetin ekzistues do të gjykojnë nga Albgaz sh.a. të domosdoshme për investim: (30.000.000 € / 4 050 000 000 ALL)

- Rinovimi dhe plotësimi me komponente të linjës Drenovë – Ballsh 5.5 km në përputhje me Rregullat e Gazit në fuqi për Industrinë e Gazit.
- Rinovimi dhe plotësimi me komponente të linjës Fier – Ballsh 24 km në përputhje me Rregullat e Gazit në fuqi për Industrinë e Gazit.
- Rehabilitimi, plotësimi me komponente dhe vënia në gjendje pune të linjës Delvine – Ballsh 101.5 km në përputhje me Rregullat e Gazit në fuqi për Industrinë e Gazit.
- Rikonstruksion i plotë i stacionit të kompresorëve Drenovë si dhe njësisë mbështetëse të këtij stacioni si dhe rivitalizimi i të gjithë separateve në përputhje me Rregullat e Gazit në fuqi për Industrinë e Gazit.
- Riparimi dhe kompletimi i rrjeteve ekzistuese të hidranteve në Ballsh dhe Fier.

E. Sipas nevojave të parashikuara nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, 2 automjete pick up, 2 motorra dhe 2 vetura për përdorim nga administrata e Albgaz sh.a.

Nr	EMERTIMI	Njesia	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
I	TE ARDHURAT (shp.transporti tras)	000, L	166,070	343,260	564,890
a	Nga Transmetimi Gazit	000, L	144,440	300,000	500,000
b	Marredhanjet me të tretet	000, L			
c	Mirëmbajtje TAP sipas VKM 233 dt 21.03.2017	000, L	21,630	43,260	64,890
II	SHPENZIME GJITHSEJ (A+B+C+D)	000, L	163,204	243,143	263,358
III	Rezultati Financiar (Fitim/Humbje)	000, L	2,866	100,117	301,532
A.	SHPENZIME KONSTANTE (1+2+3+5+6+7)	000, L	113,052	165,945	178,440
1	Shpenzimet për pagat (a+4)	000, L	81,652	85,888	94,477
a	Fond page	000, L	79,600	83,600	91,960
2	b-Trajtime	000, L	16,200	17,820	19,602
	*Kuota ushqimore	000, L	15,480	17,028	18,731



	*Antidoda	000, L	720	792	871
3	Sigurimet shoqerore (16.7%)	000, L	12,400	13,640	15,004
4	Shperblime	000, L	-	7,157	7,873
5	Shpenzime Keshilli Mblqyres	000, L	2,052	2,288	2,517
6	Amortizimi	000, L	2,600	41,000	41,000
6a	<i>Amortizimi per vitin e pare te investimit</i>	000, L	44,219		
7	Te tjera konstante	000, L	200	440	484
	*Interes mbi huane e Bute TAP AG	000, L	-	4,347	4,347
	*Interes Kredie	000, L	-	6,000	6,000
	* Fond Rezerve per Kompesime	000, L	-		-
	* Ndihma per semundje e fatkeqsi	000, L	400	440	484
B.	SHPENZ.VARIABLE (8+9+10+11+12+13)	000, L	50,152	77,198	84,918
8	Shpenzime materiale	000, L	5,768	9,185	10,104
	*Karburant	000, L	1,600	5,280	5,808
	*Lubrifikant	000, L	817	825	908
	*Te tjera material pjese kembimi	000, L	2,951	440	484
	*Te tjera materiale dhe sherbime	000, L	400	1,760	1,936
	*Veshje pune per terren	000, L	-	880	968
8A	# Veshmbathje	000, L	-		-
9	Energjia elektrike	000, L	9,200	10,120	11,132
10	Sherbime nga te trete	000, L	4,000	6,380	7,018
	*Riparime makineri e pajse	000, L	4,000	4,400	4,840
	- Nga Albpetrol	000, L			-
	- Nga Shoqeri te tjera Private	000, L			-
	*Transport	000, L			-
	- Nga Albpetroli (Parku i Naftes)	000, L			-
	- Ruajtje objekti	000, L	-	1,980	2,178
11	*Shpenz.Zhdem,Rregull,Pastr.Mjedisi	000, L	1,000	1,100	1,210
12	Shpenzime Administrative	000, L	29,784	50,153	55,129
	*Dieta Udhetimi	000, L	4,000	7,150	7,865



	*Kancelari	000, L	1,400	13,200	14,520
	*Shpenzime te tjera- Pritje/percj	000, L	200	13,200	14,520
	*Shpenzime qera	000, L	8,400	9,240	10,164
	*Shpenzime bankare	000, L	100	110	121
	*Shpenzime Telefonie	000, L	880	968	1,065
	*Shpenzime Gjyqi e noterie	000, L	2,684	2,915	3,207
	*Inv l imet	000, L	820		
	*Shpenzime Projektim/Mbikqyrje/Kolaudim/	000, L	8,000		-
	*Tatim pasurie,taksa,siguracion, etj.	000, L	1,200	1,320	1,452
	*Vleresim mjedisor	000, L	1,500	1,650	1,815
	*Shpenzime Mjekesore	000, L	200		
	*Mirembajtje Zyra	000, L	400	400	400
13	Shpenzime per Ngritje Kapaciteti/ Nuk perfshihen ne Rezult Financiar	000, L			
	Kualifikim Stafi	000, L	10,500		
	Materiale Promo dhe Shpenz Marketing	000, L	5,000		
	Informatizimi	000, L	880		
13	Humbje (energjiN+G+Holl.+K.+E+Interes.)	000, L	400	50	50
A	Investime Gjithesej=(B+C+D)	000, L	4,090,850	603,235	656,609
B	Ndertim-Montime-Tubacione	000, L	4,050,000	570,000	620,000
C	Makineri e Pajisje(a+b)	000, L	12,000	1,500	1,700
	a)Blerje Mak-Pajisje	000, L	10,000	1,000	1,000
	b) Rem. Kapital makineri dhe Pajisje	000, L	2,000	500	700
D	Shuma '1+2+3+4+5+6	000, L	28,850	31,735	34,909
1	Mjedisi	000, L			-
2	Informatizimi	000, L	7,425	8,168	8,984
3	Pajisje dhe Orendi	000, L			-
4	Ngritje Kapaciteti teknik	000, L	6,075	6,683	7,351
5	Pajisje vleresuese per terren	000, L	14,850	16,335	17,969
6	Te tjera	000, L	500	500	500



9. Kontrolli dhe auditimi

Shoqëria implementon sisteme të informatizuara të kontrollit me anë të SCADA Systems, ku në kohë reale ndiqen statuset, performance operacionale dhe ndërhyrjet në kohë për cdo devijim performance nga plani ose targeti i paracaktuar.

Përpos aktivitetit operacional, shoqëria kontrollohet nga Zyra Ekonomike dhe nga Auditi i Jashtëm, të cilët shqyrtojnë veprimtarinë dhe respektimin e kuadrit ligjor, financiar dhe administrativë.

Zyrtari i përputhshmërisë do të jetë një specialist i posacëm për të mbështetur më tej Këshillin Mbikqyrës duke u angazhuar në detyrat e mëposhtme:

- Monitorimi dhe zbatimi i programit të përputhshmërisë dhe raportimi sipas termave dhe kushteve kontraktuale,
- Raportim i vazhdueshëm i OST për llogari të organeve kompetente,
- Investigimi i konflikteve të mundshme brenda shoqërisë dhe raportimi i shkeljeve.



10. Gas-Masterplani: Projektet prioritarë PIP02 dhe PIP03.

Në zbatim të Ligjit për Sektorin e Gazit Natyror 102/2015,

§46: *Zhvillimi i Rrjetit dhe Vendimet e Investimeve,*

§56: *Zhvillimi i Rrjetit të Shpërndarjes dhe i Planit të Investimeve,*

Operatori i sistemit të Transmetimit dhe/ose Shpërndarjes, paraqet në ERE planin e zhvillimit dhjetëvjeçar të *rrjetit të transmetimit*¹, në bazë të kërkesës dhe ofertës, pasi është konsultuar me të gjitha palët e interesuara dhe që premtën masa efikase për të garantuar sigurinë dhe përshtatshmërinë e furnizimit me gaz natyror. Gjithashtu si operator i kombinuar, hartohet një plan-zhvillimi i *rrjetit të shpërndarjes*², me qëllim garantimin e sigurisë, besueshmërisë dhe cilësisë së furnizimit në sistemin e shpërndarjes.

Operatori i kombinuar Albgaz sh.a merr në konsideratë dispozitat ligjore për mbrojtjen e mjedisit dhe të eficiencës së energjisë.

Sipas §46, Pika 2, Plani i zhvillimit të rrjetit të transmetimit duhet të:

- Konsiderojë informacionin për pjesëmarrësit në tregun e gazit natyror, si dhe informacionet në lidhje me infrastrukturën e transmetimit që do të ndërtohet dhe zhvillohet përgjatë 10 viteve të ardhshme,
- Identifikojë investimet e reja të cilat do të fillojnë nga ekzekutimi brenda 3 viteve, si dhe përcaktimi i afateve kohorë të projekteve në fjalë.

Plani i zhvillimit për PIP02

Gazsjellësi i ri përfshin rrjetin e transmetimit, Stacionet e Reduktimit dhe Matjes së Presionit (PRMS) në Fier dhe Ballsh, dhe stacionet e presionit të lartë dhe të mesëm për rrjetet e shpërndarjes siç paraqiten në Figurën 1.




Fig.1

Tubacioni i planifikuar fillon në pikën e lidhjes me TAP-in në afërsi të Fierit.

Sasitë e konsumit janë përcaktuar gjatë fazës së MPG. Tubacioni është projektuar për 80% të potencialit të kërkesës për gaz në familje, shërbime dhe industrinë e vogla dhe konsumatorët e



mëdhenj potencialë të gazit (termocentralet, rafineritë etj.), të gjitha në përputhje me praktikat më të mira të planifikimit të tubacionit

Tubacioni është projektuar dhe është dimensionuar në atë mënyrë që të mundësojë furnizimin e sasive të nevojshme të gazit për të gjitha qendrat e planifikuara konsumit përmes rrugës më optimale të mundshme.

Njësitë e qeverisjes vendore (NJQV) do të furnizohen me sistemet e shpërndarjes, të cilat gjithashtu mund të jenë me presion të lartë ose presion të ulët sipas kërkesës.

Për cilësinë e gazit dhe llogaritjet e lidhura me to janë marrë në konsideratë kushtet e mëposhtëme:

- Presioni Standard: 1,01325 bar
- Temperatura Standarde: 15° C

Parametrat e përgjithshme të tubacionit të transmetimit:

- Presionet operative maksimale të lejueshme:
 - Llogaritjet janë bazuar në një presion maksimal të furnizimit prej 50 bar në një temperaturë prej 10°C prej stacioneve të reduktimit të presionit në gazsjellësin TAP
- Materialet standarde:
- Përçueshmëria e mureve të tubacionit: 45 W/m/K
- Trashësia e mbulesës prej polietileni: 3.5 mm
- Konduktiviteti i mbulesës prej polietileni: 0.35 W/m/K
- Rrugët e tubacionit janë të projektuar për të lidhur qendrat e konsumit nëpërmjet rrugës më të shkurtër të mundshme duke i kushtuar vëmendje të veçantë përzgjedhjes së terreneve që lehtësojnë ndërtimin e gazsjellësit, dhe që shmangin ose minimizojnë ndikimet mjedisore dhe sociale.



- Në këtë projekt, një tjetër faktor përcaktues në përcaktimin e korridoreve më të mira të mundshme ishte edhe prania Konsumatorëve Spirancë (Bankers Petroleum dhe rafineritë në Fier dhe Ballsh) si edhe prania e tubacioneve ekzistuese të naftës dhe të gazit që lidhin fushat e naftës rreth Fierit dhe Ballshit me rafineritë e Fierit dhe Ballshit. Përcaktimi i gazsjellësit përgjatë korridoreve të tubacioneve ekzistuese konsiderohet shumë i dobishëm, sepse minimizon ndikimet sociale dhe shpronësimet. Në figurën më poshtë janë paraqitur korridoret ekzistuese të naftës dhe gazit, të cilat u identifikuan gjatë vlerësimit.
- Rrugët e tubacioneve ekzistuese u gjeoreferencuan në sistemin GIS nëpërmjet dixhitalizimit të vizatimeve origjinale. Rrjedhimisht, niveli i saktësisë së vendndodhjes së tubacioneve ekzistuese mbi hartat topografike dhe orthofotot është e njëjtë me nivelin e saktësisë së vizatimeve origjinale të tubacionit.
- Në figurën më poshtë, përveç tubacioneve ekzistuese, janë paraqitur pika të tjera të rëndësishme si; Pika e Lidhjes me TAP-in (TAP CP1), vendndodhja stacioneve të reduktimit dhe matjes së presionit (PRMS Fier dhe PRMS Ballsh), dy rafineritë, (Fier dhe Ballsh) dhe Bankers Petroleum.




Fig.2: Korridoret perspektive te gazsjellesit

Për hir të analizës, korridori perspektiv i gazsjellesit nga pika e daljes së TAP-it në PRMS Ballsh u nda në gjashtë segmente. Në pjesën nga PRMS Fier në Lalar (Segmenti 2), u identifikuan dy opsione; Opsioni 1 përgjatë korridorit të tubacionit ekzistues, dhe Opsioni 2 përgjatë lumit Gjanica dhe hekurudhës Fier-Ballsh. Në pjesët e tjera korridori është i përbashkët.



Kostot e investimit:

Kostot e investimit përfshijnë kostot fillestare të ndërtimit të gazsjellësit, kostot për mbushjen fillestare të tubacioneve me gaz dhe shpenzimet lidhur me zëvendësimin e aseteve të amortizuara plotësisht.

Kostoja e sasisë së gazit që është i nevojshëm për mbushjen fillestare të tubacioneve të gazsjellësit u konsiderua 0.322 Euro/m^3 . Supozohet se këto shpenzime do të ndodhin gjatë vitit të fundit të ndërtimit.

Kostot e ri-investimeve për zëvendësimin e aseteve të zhvlerësuara nuk janë marrë parasysh meqë kohëzgjatja e pritshme e aseteve e kalon periudhën e marrë në konsideratë.

Së fundmi, u faktorizua në llogaritjet një fond emergjence prej 10% për shpenzime të paparashikuara.

Periudha e ndërtimit:

Periudha ndërtimore për të dy rastet e investimeve supozohet të zgjasë dy vjet dhe periudha para-ndërtimore zgjat një vit, sipas volumeve të mëposhtme: Viti i parë = 10%, Viti i dytë = 45% dhe Viti i tretë = 45%.

Burimet e financimit:

Në përgjithësi, investimet në sektorin e energjisë janë angazhime afatgjata dhe për këtë arsye fondet e tyre varen nga përdorimi i skemave të investimeve me maturitet afatgjatë. Për sa i përket investimeve për këtë projekt, financimi do të përcaktohet kryesisht nga flukset monetare që pritet të gjenerohen nga konsumatorët spirancë, që përfaqësojnë një fluks afatgjatë të të ardhurave.

Plani i zhvillimit për PIP03

Zona e projektit PIP3 shtrihet brenda territoreve të prefekturave Tiranë dhe Durrës dhe përfshin bashkitë Tiranë, Vorë, Durrës dhe Shijak, shtrirja gjeografike e të cilave është si në figurën më poshtë.



Fig.3: Harta administrative e prefekturave të përfshira nga PIP03

Tabela 1: Popullsia dhe sipërfaqja e prefekturave të prekura

Prefektura	Popullsia	Sipërfaqja (km ²)	Dendësia e Popullsisë banorë/km ²
Tiranë	749,365	652	454
Durrës	262,785	766	343

Bashkia e Tiranës përfshin 25 njësi administrative, prej të cilave 11 i përkasin qytetit të Tiranës, dhe 14 i përkasin zonës rurale dhe përfshijnë 135 fshatra. NjQV rurale janë ato të Petrelës, Farkës, Dajtit, Zall-Bastarit, Bërzhitës, Krrabës, Baldushkut, Shëngjergjit, Vaqarrit, Kasharit, Pezës, Ndroqit dhe Zall-Herrit.

Bashkia e Tiranës përfaqëson qendrën ekonomike të Shqipërisë, për shkak të përqendrimit të numrit më të madh të bizneseve dhe industrisë në nivel kombëtar. Nga NjQV-të e kësaj bashkie, Kashari është më i industrializuari edhe në nivel kombëtar, si rezultat i përqendrimit të bizneseve dhe industrive përgjatë autostradës Tiranë-Durrës.

Bashkia Tiranë paraqet shkallën më të lartë të urbanizimit për kilometër katror në nivel kombëtar, mbas bashkisë së Durrësit.

Bashkia e Durrësit përbëhet nga gjashtë njësi administrative: Durrësi, Sukthi, Ishmi, Katundi i Ri, Rashbull dhe Manza, i cili përfshin tri qytete (Durrës, Sukth, Manzë) dhe 39 fshatra.

Durrësi është qyteti bregdetar më i madh shqiptar dhe në portin e tij kalon më shumë se 90% e transportit detar në nivel kombëtar, që e bën këtë qytet një nga më të rëndësishme tregtare në vend. Për shkak të objekteve ekzistuese në portin detar të Durrësit, një numër i rëndësishëm i kompanive industriale janë vendosur brenda territorit të kësaj bashkie. Me mbi 5600 aktivitetet ekonomike dhe 15% të investimeve të huaja, Durrësi renditet si zona e dytë më e fortë ekonomike në nivel kombëtar, pas Tiranës. Ndër aktivitetet e lehta industriale, industria e



fasonerisë, prerja dhe prodhimi i këpucëve dhe rrobave, punëson një numër të lartë punonjësish, veçanërisht gra. Përveç kësaj, në këtë bashki, 5 km në veri të qytetit të Durrësit, ndodhet zona industriale e Porto-Romanos.

Sasitë e konsumit janë përcaktuar gjatë fazës së MPG. Tubacioni është projektuar për 80% të potencialit të kërkesës për gaz në familje, shërbime dhe industrinë e vogla, të gjitha në përputhje me praktikën më të mirë të planifikimit të tubacioneve.

Njësitë e qeverisjes vendore (NJQV) do të furnizohen nëpërmjet sistemeve të shpërndarjes, tubacionet e të cilave gjithashtu mund të jenë me presion të lartë, sipas kërkesës.

Sasitë e planifikuara për furnizimin me gaz të NJQV-ve të ndryshme janë listuar në Tabelën 5-1 më poshtë. Tabela paraqet sasinë e nevojshme të gazit për furnizimin e konsumatorëve në bazë vjetore.

Tabela 2: Konsumi potencial i gazit natyror në bazë vjetore

Albania	Sektori Rezidencial [mmk/vit]	Sektori i Shërbimeve [mmk/vit]	Sektori Industrial [mmk/vit]	Konsumi Total [mmk/vit]	Kapaciteti Total [m ³ /h]
PRMS TIRANA 2	119.2	71.4	32.3	222.9	112,160
PRMS DURRËS	61.1	26.4	119.4	207.9	74,325

Vlerësimi i korridorit të gazsjellësit është kryer për të verifikuar fizibilitetin dhe mundësinë e ndërtimit të gazsjellësit në rrugën e përcaktuar gjatë përgatitjes së Master Planit të Gazit. Segmentet e korridorit të gazsjellësit dhe pikat kritike të tij janë inspektuar duke vizituar pikat kryesore dhe pikat e kryqëzimit me lumenjtë, rrugët automobilistike dhe hekurudhat.

Në përgjithësi, vlerësimi i rrugës së gazsjellësit konfirmoi se rrugët e përzgjedhura janë të mundshme për të ndërtuar gazsjellësin në përputhje me praktikën më të mirë të ndërtimit të

tubacioneve. Këto praktika janë përshkruar në këtë raport dhe janë specifikuar teknika të veçanta të ndërtimit, për shembull, teknika që zbatohen në kalimet kryesore.

Rruga e tubacionit kalon në toka bujqësore të rrafshëta ose kodrinore, madje edhe me disa segmente mjaft të pjerrëta. Korridori i tubacionit kryqëzohet me disa lumenj, hekurudha, rrugë nacionale, rrugë dytësore dhe rrugë rurale. Gjatë analizës është vlerësuar dhe konfirmuar përshtatshmëria e çdo vendkalimi për teknikën e propozuar të kalimit.




Figura 4: Korridoret e gazsjellësve drejt PRMS Tirana 2 dhe PRMS Durrës

Gazsjellësi drejt PRMS Durrësit është ndërmjet 14.5 dhe 16.7 km i gjatë, në varësi të opsionit të zgjedhur. Dy opsione për këtë gazsjellës janë marrë në konsideratë, siç tregohet në *Figurën 4*. Opsioni i parë lidh PRMS Pezën, një objekt i planifikuar mbi tubacionin IAP me vendndodhjen jugore të PRMS Durrësit. Opsioni 2 lidh PRMS Fushë-Prezën, që është një objekt i ri i propozuar përgjatë gazsjellësit IAP me vendndodhjen alternative veriore të PRMS Durrësit.

Gazsjellësi PRMS Pezë - PRMS Tiranë 2 është 17 ose 18.6 km i gjatë, në varësi të opsionit të zgjedhur. Dy opsione për këtë gazsjellës janë marrë në konsideratë, siç tregohet në *Figurën 4*. Në këtë figurë paraqitet edhe rruga e IAP-it, e cila është përcaktuar tashmë në një studim të mëparshëm fizibiliteti (WB5-REG-ENE-03, 2014). Gjatë fazave të mëtejshme të projektimit, mund të jetë e mundur zhvendosja e PRMS Pezës për të akomoduar rrugën e përzgjedhur për degën drejt Tiranës.

Një pjesë e madhe e rrugës është përzgjedhur gjatë MPG. Të gjitha opsionet e mundshme të rrugëve të tubacionit u analizuan nga pikëpamja teknike, ekonomike, mjedisore dhe sociale, dhe opsionet e përmendura më lart janë përzgjedhur për analizë më të hollësishme gjatë fazës së PIP-ve.

Kostot e investimit:

Kostot e investimit përfshijnë kostot fillestare të ndërtimit të gazsjellësit, kostot për mbushjen fillestare të tubacioneve me



gaz dhe shpenzimet lidhur me zëvendësimin e aseteve të amortizuara plotësisht gjatë periudhës së marrë në konsideratë.

Kostoja e sasisë së gazit të nevojshëm për mbushjen fillestare të tubacioneve të gazsjellësit u konsiderua 0.322 Euro/m³. Supozohet se këto shpenzime do të ndodhin gjatë vitit të fundit të ndërtimit.

Kostot e ri-investimeve për zëvendësimin e aseteve të zhvlerësuara nuk janë marrë parasysh meqë kohëzgjatja e pritshme e aseteve e kalon periudhën e marrë në konsideratë.

Së fundmi, u faktorizua në llogaritjet një fond emergjence prej 10% për shpenzime të paparashikuara.

Periudha e ndërtimit:

Periudha ndërtimore për të dy rastet e investimeve supozohet të zgjasë dy vjet dhe periudha para-ndërtimore zgjat një vit, sipas volumeve të mëposhtme: Viti i parë = 10%, Viti i dytë = 45% dhe Viti i tretë = 45%.

Burimet e financimit:

Në përgjithësi, investimet në sektorin e energjisë janë angazhime afatgjata dhe për këtë arsye fondet e tyre varen nga përdorimi i skemave të investimeve me maturitet afatgjatë.

Për qëllimet e kësaj analize, sasia e financimit të borxhit është supozuar të jetë në nivelin e 50% të kostos së investimit sipas termave të mëposhtme:



- ⇒ Periudha e shlyerjes së borxhit: 12 vjet,
- ⇒ Norma e interesit: 5% në vit
- ⇒ Norma e interesit gjatë periudhës së ndërtimit: 5% në vit
- ⇒ Pagesat do të kryhen me këste vjetore të barabarta
- ⇒ Periudha fillestare e mospagimit: 3 vjet (faza e ndërtimit).

Genci GJEÇI
Administrator

OPERATORI I KOMBINUAR I GAZIT NATYROR

ALBGAZ SH.A.

